

POINT AND SHOOT

FLETA E PUNËS

UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E FILMIT NË KLASË

Kjo fletë e punës është përgaditur nga mësime të: Ardian Sallauka, SHML "Jeta e re" Suharekë

Kujtesa Salihu – Keka, SHML "Xhavit Ahmeti" Gjilan

Selvete Poniku, "Shk. e kompetencave" Prizren

Gyltene Isufi, "Zenit" Prishtinë

Fatlume Hyseni, SHML "Zenel Hajdini" Gjilan

Beqir Mustafa, SHML "Xhelal Hajda" Rahovec

Të drejtat autoriale të fletës së punës i takojnë DokuFest dhe nuk mund të përdoret pa miratim paraprak nga DokuFest.

Përshkrimi i Filmit

Me përdorimin e gjerë të telefonave të mençur dhe mënyrat e lehtësuara të shpërndarjes së videove në internet, mediat digjitale kanë ndryshuar mënyrën se si i shohim dhe dëgjojmë për ngjarjet aktuale. Kur pothuajse të gjithë në një protestë ose në zonë lufte kanë një kamerë, vija e hollë mes gazetarisë dhe formave të tjera të lajmeve shpesh janë paqarta.

Përmes klipeve nga ky film nxënësit do të kenë mundësi me hulumtu ndikimin e këtyre paqartësive në perceptimin e përgjithshëm dhe të kuptojnë se çfarë e bën gazetarinë e sinqertë të veçantë.

Filmi përcjell rrugëtimin e mahnitshëm të Matt VanDyke, një 26 vjeçar me çrregullim obsesiv-kompulsiv që u largua nga shtëpia e tij në vitin 2006 për ta sfiduar veten me "testin e burrërisë". Ai e bleu një motoçikletë dhe një kamerë dhe filloj rrugëtimin disa vjeçar nga Afrika e Veriut në drejtim të Lindjes së Mesme. Kur revolucioni shpërtheu në Libi, ai iu bashkua rebelëve që luftonin kundër Muamar Gadafit, por u kap, duke dërguar aventurën e tij në një drejtim të ri të frikshëm.

Filmi pasqyron se si sot përdoren kamerat jo vetëm për të regjistruar tregime, por edhe për ti krijuar ato.



Tema Kryesore:

Identiteti personal, Revolucioni ideologjik

Njësitë Mësimore:

Çrregullimet psikologjike, Agresiviteti, Konfliktet, Të mësuarit në bazë të imitimit, Mediat, Pasurimi i fjalorit, Lindja e Mesme, Diversiteti Kulturor.

Fushat e Kurrikulës:

Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna.

Përshtatshëm për:

Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasat X- XI -XII.

Kompetencat:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, Kompetenca e të mësuarit, Kompetenca qytetare.

Objektivat:

Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare, Evitimi i paragjytimeve, Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.



Shfaqja e facilituar

Shfaqja e facilituar bazohet në ciklin e mësimnxënies. Një shfaqje filmi pasohet nga një diskutim me audiencën. Ky proces ndihmon audiencën që të shikojnë filmin me sy kritik, reflektojnë, angazhohen duke e parë problemin lokal në kontekst global, dhe përfundimisht të merren veprime të duhura që mund të ndikojnë në ndryshim shoqëror. Ky udhëzues e faciliton diskutimin në ambientin e klasës.

Shikoni Filmin. Publiku e shikon filmin si grup.

Reflektoni mbi filmin. Pas shfaqjes, audienca reflekton mbi filmin e shikuar, duke i ndarë pikëpamjet, ndjenjat dhe reagimet e tyre. Thelbësore për këtë qasje është njohja që çdo individ ka ide dhe mban vlera që janë të rëndësishme për ta. Duke e ndarë këtë njohja dhe respektimi i ideve, ndjenjave dhe vlerave të ndryshme ndihmon audiencën për të mësuar nga njëri-tjetri.

Shihni përtej kontekstit lokal. Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit duhet të ekzaminojnë, debatojnë dhe analizojnë çështjet e ngritura në film. Për ta marrë këtë më tej, audienca inkurajohet të lidh filmin dhe çështjet në jetën e tyre dhe ti kuptojnë më mirë të njohuritë e përbashkëta që ata posedojnë.

Vepra. Audienca i konsideron veprimet që mund të ndër marrin për të adresuar varfërinë dhe pabarazinë në jetën e tyre dhe të komuniteteve, vendeve por edhe në nivel ndër-kombëtar.




Diskutimi

Verzoni 45 minutësh i filmit mund të shfaqet si aktivitet jashtëkurrikular me nxënës të klasave të ndryshme, ku këto diskutime mund të përsëriten ose mund të ftohen nxënësit të reflektojnë për postimet e tyre në rrjete sociale. Në një pjesë të filmit Matt flet për mënyrën se si rebelët në Libi donin të filmoheshin / fotofoheshin në një mënyrë të caktuar për Facebook, kështu që ata mund të krenohen me këto pamje.

1) A vlen kjo edhe për ne të cilët nuk jemi në beteja por jemi duke krijuar lajme për jetën tonë personale?

2) Si ka ndikuar përdorimi i kamerave, telefonëve mobil dhe prania e rrjeteve sociale në mënyrën se si ne e "portretizojmë" jetën private? A krijojmë imazhe të idealizuara të vetëvetes për t'i paraqitur botës?

3) A do të ndikojë fakti se dokumentimi ndikon si veprojme apo prezantohemi në kamera?



Aktivitetet

Aktiviteti 1:

(EVOKIM)

Pyetni nxënësit se çka kuptojnë me termin "Diversitet".

Pyetni se sa e njohin kulturën në Lindjen e Mesme. (10 Min)

Aktiviteti 2:

(REALIZIM)

Lëshoni pjesën e filmit për pjesën përkatëse.

Ndani nxënësit në grupe dhe kërkoni nga ata që të diskutojnë dhe argumentojnë dallimin e kulturave. Kërkoni shembuj konkret nga inserti i shikuar. (20 Min).

Aktiviteti 3:

(REFLEKTIM)

Përgatitni paraprakisht një kuiz për lëndën përkatëse. Testoni njohuritë e përfituara nga këto aktivitete. (15 Min).

Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të njohura gjithashtu si Qëllimet Globale, u miratuan nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015 si një thirrje universale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet deri në vitin 2030.

17 SDG janë të integruara - domethënë, ata e pranojnë që veprimi në një zonë do të ndikojë në rezultatet në të tjerët, dhe se zhvillimi duhet të balancojë qëndrueshmërinë sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Nëpërmjet premtimit për të lënë askend pas, vendet janë zotuar të ndjekin përparimin e shpejtë për ata më të rrezikuarit sa më parë. Kjo është arsyeja pse SDG-të janë krijuar për të sjellë botën në disa 'zero' që ndryshojnë jetën, duke përfshirë zero varfërinë, urinë, SIDA'n dhe diskriminimin ndaj grave dhe vajzave.

Të gjithë janë të nevojshëm për të arritur këto objektiva ambiciozë. Krijimtaria, njohuria, teknologjia dhe burimet financiare nga e gjithë shoqëria është e nevojshme për të arritur SDG-të në çdo kontekst.

SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS



DokuFest përmes programit edukativ në kuadër të departamentit DokuLab është përkushtuar që të senzibilizojë rininë, për të mësuar më shumë për Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm kryesisht përmes shfaqjeve të filmave nëpër shkolla dhe trajnimit të mësimeve në përdorimin e filmit dhe mjeteve audiovizuale në procesin mësimor. Ky udhëzues është prodhuar me këtë qëllim dhe është i bashkërenduar me kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar.

Filmat tjerë që korespondojnë me këtë temë dhe të cilat mund të përdoren për trajtimin e temave të edukimit mediatik janë:

Our New President
Like
Cleaners
Art War
Bellingcat

Lexo më shumë në këtë temë:

Columbia Journalism Review
<http://www.cjr.org>
Merchants of Doubt
www.takepart.com/merchants-of-doubt - Poynter
www.poynter.org

Learn about SDG's: <http://17goals.org/>

Për të kërkuar shfaqjen e filmit vizitoni Bibliotekën Digjitale të Mësimdhënesit në <https://dokufest-lab.com/>